



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.465/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Anton Quni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.465/2019 i datës 08.11.2019, i paraqitur nga Anton Quni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të përfshihen 563 vota në rezultatit përfundimtarë të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel më datë 08.11.2019, të paraqitur nga Anton Quni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilin pretendohet se pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të datës 07.11.2019, për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 06.10.2019, nga KQZ-ja, në formularët e rezultateve (FRD dhe FRK), totali i votave përmes postës nuk përputhet me atë të publikuar më parë. Kandidati në fjalë me tutje thekson se nga totali i votave me postë që do të duhen të jenë 974 vota figurojnë vetëm 411 vota. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i, të bëjë shqyrtimin e apelit të tij, ndaj publikimit të rezultateve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në këto fakte: te votimi përmes postës, të datës 16.10.2019 të publikuara nga KQZ-ja, prej BM001-001 deri BM031-001, me të cilën nuk janë publikuar në rezultatet e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me tutje parashtruesi thekson se me datën 16.10.2019 ka marrë gjithsej 563 vota BM001-001 deri BM031-001. Te votimi përmes postës të datës 01.11.2019 të publikuar nga KQZ-ja, 40BM40 prej BM040-001 deri BM040-023, sipas parashtruesit ka pranuar gjithsej 304 vota. Te votimi përmes postës e datës 05.11.2019 të publikuara nga KQZ-ja, 41BM41 prej BM041-001 deri BM041-012 sipas parashtruesit ka pranuar gjithsej 107 vota. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëjë shqyrtimin e ankesës së tij dhe në rezultatit përfundimtar të votave t'i përfshijë edhe 563 vota.

Në përgjigje në apel të datës 09.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kaloj (procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen

votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të te gjeturave përgatit raportin dhe QNR, në bazë të raportit të Auditimit rekomandon KQZ-në, që vendotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave tjera të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se paraqitësi në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij, prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me prova konkrete, pasi që paraqitësi i apelit vetëm pretendon se me rastin e rinumërimit nga KQZ-ja, ka mospërputhje mes FRD dhe FRK, ashtu që totali i votave përmes postës nuk përputhet me rezultatin e publikuar më parë dhe pritjet e tij, nuk nënkuptojnë se ka mospërputhje të rezultatit, andaj si i tillë apeli është jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 të LZP-së. Po ashtu lidhur me këtë çështje, Paneli ka konstatuar se mospërputhja për të cilën pretendon paraqitësi i apelit nuk ekziston, pasi që në rezultatet e paraqitura nga KQZ-ja për kandidatin Anton Quni, figurojnë të gjitha votat të cilat i njëjti pretendon se mungojnë.

Rrjedhimisht PZAP-i, në mungesë të provave, dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.465/2019 më datë 09.11.2019



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.